



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:294889

Datë: 30.12.2020

Numri i dokumentit: 01381926

C.nr. 684/2019

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini në çështjen kontestimore të paditëses, N.Nnga fshati Mogillë, Komuna e Kllokotit, të cilën e përfaqëson, Visar Musa, avokat me seli të zyrës në Ferizaj rr. e “Reçakut” Lokali D2, kundër të paditurës Komuna e Kllokotit, cilën e përfaqëson, Lirije Zeqiri – Halabaku, me objekt kontesti kompensimi i ushqimit, vlera e objektit të kontestit 1332 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 24.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet kërkesëpadia e paditëses N.Nnga fshati Mogillë, Komuna e Kllokotit, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Kllokotit dhe, detyrohet e paditura që paditëses në emër të ushqimit për 666 ditë pune, për periudhën 18.04.2017 deri me 18.12.2020, t’ia paguaj shumën prej 1332 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 20.12.2019 e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë ditëve, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. Detyrohet e paditura që paditës t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 260 Euro.

IV. Detyrohet paditësja që t’ia paguaj gjykatës taksën shtesë prej 10 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësja Pranvera Pira, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, me padinë e datës 20.12.2019 dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga Gjykata, t’ia aprovojë kërkesëpadinë për kompensimin e ushqimit ditorë nga 2 Euro në ditë, për 666 ditë pune, të llogaritur nga data 18.04.2017 deri më 18.12. 2020, në shumë prej 1332 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data e dorëzimit të padisë në gjykatë – 20.12.2020 e deri në pagesën definitive. Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.12.2020, e ka tërhequr pjesën e padisë sa i përket kërkesës për kompensimin e shpërblimit jubilar, gjë të cilën, e paditura nuk e ka kundërshtuar, ashtu që, gjykata me aktvendim procedural, këtë kërkesë e ka konstatuar si të tërhequr.

Bazën ligjore për kërkesën e saj, paditësja e mbështeti në nenin 35, par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, për shkak se është në marrëdhënie pune në SHFMU “Gjon Serreqi” në fshatin Mogillë, dhe përkundër kërkesës para fillimit të procesit kontestimor, e paditura nuk e ka kompensuar paditësen për shujtën ditore e cila i takon sipas kontratës kolektive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përpilim të padisë 104 Euro, për

një seancë gjyqësore 135 Euro dhe për taksë gjyqësore 21 Euro, në shumë të përgjithshme prej 260 Euro.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke e cilësuar si të pa bazë ligjore për faktin se DKA-Komuna e Klllokotit nuk është përgjegjëse për moszbatimin e kontratës kolektive të vitit 2017, të cilën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe SBASHK, duke theksuar se nuk kanë linjë të veçantë buxhetore për kompensimin e detyrimeve që dalin nga Kontrata Kolektive, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Vërtetimin me nr. 379, të datës 17.12.2020, Kontratën e Punës, të datës 01.09.2015, kërkesën e paditëses, të datës 01.12.2019.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses N.Nështë e bazuar, dhe si e tillë edhe duhet të aprovohet.

Nga provat materiale të administruara gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike; paditësja N.Nështë në marrëdhënie punë te e paditura nga data 01.09.2015, dhe për realizimin e kërkesës së saj për shujtat e ushqimit, para fillimit të procedurës gjyqësore, i është drejtuar fillimisht të paditurës me kërkesën e datës 01.12.2019¹ dhe nuk ka pranuar përgjigje.

Se paditësja është në marrëdhënie të punës te e paditura u vërtetua me kontratën e punës, sipas të cilës, paditësja kishte themeluar marrëdhënie të punës në SHFMU “Gjon Serreqi” në fshatin Mogillë Komuna e Klllokotit ku ende punon, ndërsa fakti se paditësja për periudhën 18.04.2017 deri me 18.12.2020 ka qenë e pranishme në punë 666 ditë u vërtetua me vërtetimin me nr. 379, të datës 17.12.2020. Se paditësja kishte kërkuar nga e paditura kompensimin e kërkesës së saj, u vërtetua me kërkesën e dorëzuar me postë rekomande me datë 01.12.2019.

Meqenëse në bazë të provave të administruara u vërtetua gjendja faktike si më lart, gjykata e obligoi të paditurën që paditëses, në emër të ushqimit për 666 ditë, t’ia kompensojë shumën prej 1332 Euro.

Me rastin e vendosjes për kompensimin e ushqimit, Gjykata u bazua në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i cili ka paraparë kompensimin e ushqimit në punë nga 2 Euro për një ditë pune. Me rastin e vendosjes për kompensimin e ushqimit, Gjykata u bazua në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i cili ka paraparë kompensimin e ushqimit në punë nga 2 Euro për një ditë pune.

Sa i përket periudhës se kërkesës së paditëses pas datës 17.04.2020 deri me 18.12.2020, gjykata konsideron se kontrata kolektive zbatohet edhe për këtë periudhë për shkak se sipas nenit 45 “[...] nëse nga kontrata kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit [...]”. Kontrata Kolektive ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa nuk ka dëshmi se ndonjëra nga palët kontraktuese është tërhequr.

Gjykata, me qëllim të zbatimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, nuk caktoi ekspert financiar për faktin se e paditura nuk pati vërejtje në provat e administruara, andaj, llogaritja e shumave është bërë sipas përlllogaritjes së thjeshtë nga përfaqësuesi i paditëses e që nuk u kundërshtua nga përfaqësuesja e paditëses, ndërsa për gjykatën ishte e qartë si kërkesa ashtu edhe shuma e kërkuar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, të cilat u gjetën si të pa bazuara, për shkak se palët kontraktuese të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2 të kësaj Kontrate kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj

¹ Në këtë datë është dërguar me postë rekomande

Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Për më tepër, nenin 37 kanë përcaktuar se “palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë de t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”. Andaj, sipas dispozitave të këtyre neneve, e paditura është e lidhur me detyrimet që burojnë nga kjo kontratë, sepse, për gjykatën nuk ka rëndësi pretendimi që e paditura nuk ka linjë të veçantë buxhetore për kompensimin e këtyre kërkesave.

Lidhur me taksën gjyqësore për padi, gjykata, duke u bazuar në nenin 6.2 të UA.Nr.01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore, e obligoi paditësen që të paguajë shumën shtesë prej 10 Euro, duke u bazuar në nenin 12.1 të udhëzimit të lartcekur, sipas të cilit për kërkesat në para vlera e të cilave e tejkalon shumën prej 1001 Euro, taksa për padi është 30 Euro. Andaj, paditësja u detyrua që të paguajë shumën shtesë për shkak se me rastin e dorëzimit të padisë, për taksë gjyqësore, e ka paguar shumën prej 20 Euro.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që e paditura e ka humbur kontestin në këtë rast, andaj edhe obligoi të njëjtën që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 260 Euro edhe atë: për përpilimin e padisë 104 Euro, për taksë gjyqësore 21 Euro si dhe për një seancë gjyqësore 135 Euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifatat e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 684/2019, datë 24.12.2020

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:294889
Datë: 30.12.2020
Numri i dokumentit: 01381926